



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.621/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Lgjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Edona Mehanolli Lubeniqi, candidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Edona Mehanolli Lubeniqi, candidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj në Vendvotimin: 0619C/02D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 09.11.2017, nga Edona Mehanolli Lubeniqi, candidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se i mungojnë 8 vota në këtë vendvotim: 0619C/02D. Më tej ka cekur emrat e disa dëshmitarëve dhe numrat kontaktues të tyre.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 0619C/02D, është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidatja nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Istog, nuk ka asnjë votë në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i apelit i posedon 8 vota të vlefshme.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Istog nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Istog për vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 621/2017 më datën 12.11.2017.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

